

## MALI I ZI

### KOMUNA E TUZIT

Komisioni për ndarjen e mjeteve për mbështetje të afarizmit (ndërmarrësisë)

Nr.: 08-032/22-8600

Tuz, 23.08.2022

Në bazë zë nenit 3, dhe nenit 5 par. 3 pika 1 të Vnedimit mbi Kriteret, Mënyrën dhe Procedurën e ndarjes së Mjeteve për Mbështetje ndërmarrësisë („Fl. Zyrt.MZ – dispozitat komunale“ nr 22/22), Komisioni për ndarjen e mjeteve për mbështetje ndërmarrësisë,

Shpall

### KONKURS TË HAPUR

**për ndarjen e mjeteve nga buxheti i Komunës së Tuzit të destinuar për ndërmarrësi kreative**

- I. Ftohen të gjithë personat juridikë dhe fizikë me seli në Komunën e Tuzit që të paraqiten në Konkursin për ndarjen e mjeteve nga buxheti i Komunës së Tuzit, të destinuar për mbështetje të ndërmarrësisë kreative, duke e dorëzuar idenë e tyre afariste/të biznesit (në vazhdim të tekstit planin e biznesit) në këtë konkurs.
- II. Mjetet e destinuar me Buxhetin e Komunës së Tuzit shpërndahen për planet e biznesit që kontribuojnë në realizimin e qëllimeve të përcaktuara në dokumentet strategjike programet dhe planet e Komunës së Tuzit, me të cilat posaçërisht nxitet ndërmarrësia kreative.
- III. Komuna përcakton 5.000,00 € (dy ide kreative ndërmarrëse nga 2.500,00 €) për Konkursin publik për ndarjen e mjeteve nga Buxheti i Komunës së Tuzit si mbështetje ndërmarrësisë kreative për vitin 2022.
- IV. Një person fizik/ juridik mund të konkurrojë me më së shumti 2 plane biznesi, por mund të mbështetet vetëm për një plan të biznesit.  
Shuma minimale e mjeteve që i ndahen personit juridik/ fizik nuk mund të jetë më e vogël se 70% nga shuma e kërkuar për financimin e atij plani të biznesit.  
Nëse në konkursin publik paraqitet vetëm një person fizik/juridik, të gjitha mjetet e përcaktuara me buxhet për këtë qëllim mund t'i ndahen atij personi.
- V. **Konkursi për ndarjen e mjeteve është i hapur 30 ditë nga dita e publikimit të tij në gazetën ditore dhe në ueb faqen e Komunës së Tuzit.**
- VI. **Paraqitja bëhet te Komisioni dhe dorëzohet në zyrën-arkiv të Komunës së Tuzit.**

**Në zarfin e mbyllur, personat fizikë bashkëngjisin?**

1. Planin e punuar të biznesit;
2. Versionin elektronik të planit të biznesit;
3. Kopjen e vërtetuar të letërnjoftimit;
4. Letrën e qëllimit;

## 5. Profakturat.

Në zarin e mbyllur, personat juridikë që planifikojnë zhvillimin e afarizmit bashkëngjisin:

1. Planin e punuar të biznesit;
2. Kopjen e vërtetuar të letërnjoftimit të personit përgjegjës në komunikimin juridik
3. Versionin elektronik të planit të biznesit në CD ose në lexuesin USB;
4. Origjinalin apo kopjen e vërtetuar të Vendimit mbi regjistrimin e shfrytëzuesit të fundit në CRPS;
5. Vërtetimin e Drejtorisë së të Ardhurave dhe Doganave mbi obligimet e rregulluar të tatimeve dhe kontributeve, jo më të vjetër se 30 ditë
6. Vërtetimin e organit të vetëqeverisjes lokale në kompetencat e të cilës janë çështjet verifikimit, pagesës dhe kontrollit të tatimeve se shtruesi i paraqitjes nuk ka obligime të pa shlyera tatimore në vitin e kaluar, që nuk është më e vjetër se 30 ditë;
7. Forma përkatëse për muajin e fundit të pagimit të tatimit dhe kontributeve për të punësuarit e vërtetuar nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Doganave si provë mbi numrin e të punësuarve dhe 11 profaktura

## VII. Planet e biznesit që nuk do të mbështeten janë:

1. Aktivitetet që janë në kompetencë dhe përgjegjësi të Qeverisë, siç është arsimimi formal, mbrojtja shëndetësore formale etj.;
2. Planet e biznesit me të cilat kërkohen mjete financiare për mbledhjen dhe
3. Planet e biznesit që bazohen ekskluzivisht në punimin e njëhershëm, përgatitjen dhe shtypin e librave, broshurave, buletineve, revistave e të ngjashme, nëse publikimi i tyre nuk është pjesë e një programi më të gjerë ose aktiviteteve më gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme;
4. Aktivitete që vlerësohen si të jashtëligjshme dhe të dëmshme për mjedisin dhe të rrezikshme për shëndetin e njeriut: lojërat e fatit, duhani, pijet alkoolike (përpos prodhimit të verë[rave dhe rakisë së pemëve);
5. Aktivitete të pamoralshme dhe jo legale.

## VIII. Komisioni bën ndarjen e mjeteve për planin e biznesit në bazë të kriterëve pozitive eliminuese.

### **Kriteret pozitive janë:**

1. Personi fizik/juridik plani i biznesit i të cilit përfshin punësimin e personave nga territori i Komunës së Tuzit gjatë vitit të shpalljes së konkursit – 0 deri në 25 pikë;
2. Plani i biznesit ofron të gjitha të dhënat që janë të domosdoshme për fillim, udhëheqja e biznesit dhe funksionimi i suksesshëm afarist në të ardhmen – 0 deri në 15 pikë
3. Plani i biznesit ofron propozime për financimin e idesë afariste nga burimet e veta she/ose tjera financiare – prej 0 deri në 10 pikë
4. Aspekti inovativ i planit të biznesit – 20 pikë

5. Kontributi i planit të paraqitur të biznesit në realizimin e interesit publik dhe në realizimin e qëllimeve strategjike në një fushë të caktuar – prej 0 deri në 30 pikë

Për shpjegim, Komisioni mund të bëjë edhe intervistë me gojë me pjesëmarrësit e konkursit.

**Kriteret eliminuese janë:**

1. Mosplotësimi i kushteve formale për kandidim të planit të biznesit (dokumentacioni jo i plotë ose i pasaktë);
2. Plani joadekuat i biznesit (nuk korrespondon me përmbajtjen e propozuar në pajtim me nenin 13 të Vendimit).

IX. Pqaraqitja në konkurs i dërgohet Komisionit në formularin përkatës në zarfe të mbyllur me shënim: “PARAQITJA PËR KONKURS PUBLIK PËR NDARJEN E MJETEVE TË PËRCAKTUARA PËR MBËSHTETJE TË NDËRMARRËSISË KREATIVE – MOS E HAP” në origjinal ose bashkë me paraqitje dorëzohen edhe fotokopjet e vërtetuara në zyrën-arkiv të Komunës së Tuzit, adresa Tuzi p.n., përfshirë edhe më 23. 09. 2022

X. Komisioni i hap zarfet e dorëzuara në kohën e duhur në mbledhjen e parë pas skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesave.

Nëse konstaton se personi fizik/juridik nuk e ka dorëzuar komplet dokumentacionin, Komisioni e fton që ta t’i evitojë menjëherë mangësitë, e më së largu brenda tri ditësh nga dita e marrjes së thirrjes.

Nëse personi fizik/juridik nuk e eviton mangësinë në afatin e dhënë, Komisioni do ta refuzojë kërkesën.

XI. Pas marrjes së Vendimit mbi ndarjen e mjeteve dhe publikimit të tij, lidhet kontrata me të cilën rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella, mënyra e shfrytëzimit të mjeteve, raportimi mbi realizimin e planit të biznesit.

Nëse fituesi nuk e dorëzon provën për regjistrim, kontratat merret si e ndërprerë, me ç’rast Komuna e Tuzit lirohet prej të gjitha obligimeve ndaj fituesit të mjeteve.

XIII. Informatat mbi të gjitha çështjet e rëndësishme për pjesëmarrje në Konkursin Publik mund të fitohen çdo ditë pune, në numrin e telefonit 068/851-328 ( Šefko

Kurpejović); 067/706-859 ( Enisa Niković) dhe/ose ne email:

[sefko.kurpejovic@tuzi.org.me](mailto:sefko.kurpejovic@tuzi.org.me); [enisa.nikovic@tuzi.org.me](mailto:enisa.nikovic@tuzi.org.me);

[driton.gjokaj@tuzi.org.me](mailto:driton.gjokaj@tuzi.org.me)

**Kryetari i komisionit  
Driton Gjokaj**

